| 4.3. | Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse | Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse paraqiten nga pluhurat të cilët lirohen nga gurëthyesi me seperacion, qarkullimi i automjeteve transportuese dhe nga hapësirat brenda dhe jashtë kompanisë “FORTESA”sh.p.k. janë:<br>• Pluhuri gjatë procesit të punës, si dhe<br>• Pluhuri gjatë transportit të inertëve dhe bartja e lëndës se parë |
| 4.4. | Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese | Bazuar ne aktivitetin e seperacionit me gurëthyes nuk është e nevojëshme të përdorë paisje për trajtimin e gazërave për shkak se gjatë operimit ne seperacion prezent mund të jetë vetëm pluhuri. |
| 4.5. | Pajisjet për de-pluhurin | Bazuar ne aktivitetin seperacionit me gurëthyes perdore sistemin e ujit për minimizimin e pluhurit dhe paisjet adekuate për deplohurim dhe shkarkimi i saj do të jetë brenda normave të lejuarara. |
| 4.6. | Monitorimi i emisioneve | Bazuar ne aktivitetin seperacionit me gurëthyes ka ndërmmarr të gjitha masat me paisje adekuate për deplohurim dhe shkarkimi i saj do të jetë brenda normave të lejuarara e cila edhe do të monitorohet koform obligimëve ligjore ne fuqi. |
| 4.7. | Monitorimi i emisioneve/ cilësisë ë ajrit | Bazuar ne aktivitetin seperacionit me gurëthyes ka ndërmmarr të gjitha masat me paisje adekuate për deplohurim dhe shkarkimi i saj do të jetë brenda normave të lejuarara e cila edhe do të monitorohet koform obligimëve ligjore ne fuqi. |

| | | |
|---|---|---|
| 4.8. | Raportimet | Kompania “FORTESA” sh.p.k, do t’i kryëj të gjitha raportimet i cili obligohet bazuar ne kushtet e lejës dhe obligimit ligjor. |
| 4.9. | Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit | Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të thërrmimit dhe seperimit duhet të mënjanohet apo zvoglohet gjerë në kufijte e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin. Për të parandaluar e zvogluar sasinë e ndikimeve negative në ajër të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarr këto masa: Kompania duhet bërë instalimin e sistemit të ujit për zvoglimin e sasisë së pluhurit. Furnizimi me ujë duhet bërë me anë të pusit (bunarit) të cilin kompania e posedon edhe atë me thellësi deri 100m, uji me anë të pompës do të përcillet në rezervar i cili do të ndërtohet për mbajtjen e ujit rezervë, prej nga me ramje të lirë nëpërmjet gypsjellsve sillet gjer te gurthyesi me seperacion, ose drejtprdrejt me pompë elektrike nëpërmjet gypsjellsve sillet gjer te gurthyesi me seperacion të cilën procedurë e aplikon kompania në fjalë. Sistemi i ujit për zvoglimin e pluhurit i cili lirohet gjatë procesit të thërmimit dhe seperimit duhet vendosur në tërë stabilimentet të cilat lirojne pluhur dhe atë në gurthyesen primare, gurthyeset sekundare, në sitat vibruese, dhe në të gjithe shiritat transportues. Në sistemin për zvoglimin e pluhurit duhet vendosur valvulet për lëshimin dhe rregullimin e sasisë së ujit në menyrë mekanike, gjithashtu duhet të vendosen diznet të cilat e lëshojnë ujin ne formë mjegulle e cila bënë ujitjen e masës, dhe në këtë mënyrë masa e cila do të thërmohet dhe seperohet ujitet ashtu që nga masa nuk mund të lirohet pluhuri. Uji i cili shërben për mënjanimin e pluhurit duhet të rregullohet në sasi vetëm sa të bëj rrëzimin e grimcave të pluhurit që të mos shpërndahen në mjedis. Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të thërmimit dhe seperimit nëse me instalimet e sistemit të ujit nuk mund të menjanohet apo zvogelohet gjere në kufjte e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin. Kompania duhet bër instalimin e sistemit të depluhrimit me anë të filtrave që është sistem i avancuar për zvoglimin e pluhurit. Në vijim po bëjmë përshkrimin e procesit teknologjik të depluhrimit. Pluhuri i cili krijohet gjatë procesit teknologjik thithet nga |

| | | |
|---|---|---|
| | | stabilimentet me ndihmën e ajrit përmes gypave që do të montohen në vendet ku krijohet pluhuri. Sasia e ajrit të thithur do të caktohet në bazë të pervojës dhe matjeve të bëra në pajimet e vendosura për shpluhrosje. Në çdo vend për shpluhrosje ekziston flutura rregulluese me të cilën rregullohet sasia e ajrit të thithur. Te gjithe gypat janë ashtu të dimensionuar sa që shpejtësia e ajrit në ta është mjaft e madhe sa që nuk do të ketë palosje (fundërrim, ngjitje) të pluhurit në gypa. Të gjithë gypat thithës janë të lidhur me gypin kryesor mbledheës të pluhurit i cili është i kyqur ne filtrin OVF 350. Në vendet lidhëse të gypave vendosen mbyllësit e gomës të cilët shërbejne si mbyllës e njëherit edhe si izolator të ajrit. Në filtrin e thatë prej bezi nga ajri i ndotur ndahet gati e tërë sasia e pluhurit d.m.th. bëhet filtrimi i ajrit përmes bezit filtrues. Efekti i kësaj ndarje është mbi 99% .Koncentrimi i pluhurit në dalje nga filteri sillet nën 50 $mg/m^3$ e që është më pak se e lejuara 150 $mg/m^3$. Filteri i bezit është i pajisur edhe me stabilimente për pastrimin e thasëve, përndryshe shtresat e pluhurit do të pengojne krejtesisht filtrimin dhe punën e të gjitha pajimeve ose stabilimenteve. Pastrimi bëhet me ventilatorin për fryrje i cili me ndihmen e një mekanizmi largohet prej thesi në thes dhe bënë fryrjen e thasëve me levizjen e ajrit nën shtypje. Lëvizja e ventilatorit për fryerje prej thesit në thes dhe koha e pauzës në mes thasëve caktohet me ndihmen e releut kohor në pogramaturën e filterit. Ajri i pastruar nga filteri kalon përmes gypave ne ventilatorin kryesor dhe prej aty në oxhak dhe del nga sistemi për shpluherosje. Pluhuri i ndarë në filter largohet me kërmill dhe hyn në dozatorin e transportierit pneumatik prej aty me ndihmën e ajrit të komprimuar transportohet në silos. Silosi është i pajisur me nivelues i cili regjistron nivelin maximal në silos. Zbrasja e silosit bëhet me ndihmën e stabilimenteve për mbushje me dorë ose mekanike i cili kyqet në autocisterne. Për rrëzimin e pluhurit të shtresuar në pjesën konike të silosit bëhet me ajër te komprimuar. Për të parandaluar e zvogdluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë procesit teknologjik të thërrmimit dhe seperimit, përpos masave të lartcekura duhet ndërmarr edhe këto masa: |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Duhet të bëhet mirembajtja e rregullt e pajimeve për thërrmim dhe seperim, e posaqerisht stabilimenteve të cilat janë burim i emisioneve të pluhurit.<br>• Duhet të bëhet mirëmbajtja e rregullt e sistemit të instaluar për zvoglimin e pluhurit me ujë dhe pastaj me filter.<br>• Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt i thasëve filtrues të dëmtuarit të ndërrohen, nëse bëhet instalimi i sistemit të depluhrimit me anë të filtrave.<br>• Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve të rënda dhe konsumuesve tjerë të lëndëve të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga mjetet e punës të jetë sa më kualitativ. Gjithmonë duhet të bëhet spërkatja e sipërfaqeve manipuluese, rrugëve transportuese dhe fraksioneve, sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta.<br>• Duhet të jetë çdo herë në disponim autocistema me ujë për spërkatje.<br>• Kamionët të cilët bëjne transportin e skories dhe fraksioneve duhet të mbulohen me mbulesa adekuate, në kohra të thata edhe të spërkaten me ujë.<br>• Duhet të bëhet matja e emisioneve të pluhurit gjatë punës në punishte dhe në territorin më të gjerë, me qëllim të caktimit të sasisë së përbërjes së thërrmijave të pluhurit, dhe për të krahasuar vlerat e matura me vlerat kufitare të caktuara. |

| **5. UJI** | | |
|---|---|---|
| 5.1. | Të dhënat për shfrytëzimin e ujit | Operatori për nevoja të procesit teknologjik e shfrytëzon vetëm për sperkatje të gurit gelqerorë dhe për nevoja sanitare për pastrim të pajisjeve dhe hapësirave para dhe për rreth impianteve përdor ujë nga pusi të cilët gjendet në hapësirën e kompleksit të kompanisë. Pusi është i tipit klasik në thellësi |

| | | |
|---|---|---|
| | | 45m dhe me diametër të shpimit Ø145mm. Thithja e ujit nga pusi behet me anë të pompave dhe nuk nevojitet sasi e madhe e ujit për këtë aktivitet. |
| 5.2. | Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit | Kompania "FORTESA"sh.p.k, duke pasë parasysh aktivitetin thermim dhe seperim të gurit gëlqerorë gjatë procesit teknologjik nuk ka të bënë shkarkimin e ujërave pasi uji shfrytëzohet vetëm për sperkatje gjatë seperimit dhe thermimit e cila nuk ka të bëjë me pastrim të inertëve. |
| 5.3. | Ndikimet në ujë | Gjatë procesit të punës me aktivitetin thermim dhe seperim i gurit gëlqerorë, nuk shkarkohen ujera të ndotura gjatë procesit teknologjik duke e pasë parasysh qe uji i cili përdoret gjatë procesit të punës shfrytëzohet vetëm për sperkatje për të parandaluar sasinë e pluhurit.<br>Furnizimi me ujë behet për disa qëllime, nder to janë:<br>➢ Uji për nevoja te seperacionit me gurëthyes<br>➢ Uji, i cili përdorët për nevoja sanitare-zyre dhe nevoja të tjera,<br>**Masat për mbrojtjen e ujit**<br>-Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ujë gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve prodhuese dhe shërbyese në fabrikën për prodhimin e produktëve ne fjalë, duhet të merren këto masa:<br>➢ Duhet të bëhet pengimi i mundësisë për derdhjen e derivateve dhe vajrave<br>nga makinat transportuese dhe të punetoreve të cilat shfrytezohen nga kompania "FORTESA"sh.p.k .<br>➢ Ujërat të përdorura nga larja hapësirave të fabrikës<br>➢ Ujërat e të reshurave atmosferike nga sipërfaqet e betonuara dhe rruget<br>➢ Ujërat nga larja e hapësirave ku janë të vendosura pajisjet prodhuese, hapësirat nga kuzhina duhet të dergohen rrjet te kanalizimit. |

| | | |
|---|---|---|
| 5.4. | Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor | “FORTESA”sh.p.k Impianti per thermmim dhe seperimin nuk shkarkon ujera te ndorura nga aktiviteti. |
| 5.5. | Trajtimi i ujërave të ndotura | “FORTESA”sh.p.k Impianti per thermmim dhe seperimin nuk shkarkon ujera te ndorura nga aktiviteti. |
| 5.6. | Kontrolli dhe matjet | Kompania “FORTESA” Sh.p.k – nëse kërkohet që të bëhët kontrollë dhe matje te ujerave shkarkuese nga amviseria do t’i përgjigjët ndaj çdo kërkese të MMPHI-së dhe duhet te kemi parasysh UA 02/2022 për Kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujrave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor. |
| 5.7. | Raportimi | Do të bëjmë raportimin sipas kërkesës dhe bazës ligjore ne fuqi, kur do qe kërkohet nga organet përgjegjëse për raportim. Mirëpo raportimi do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e te gjitha parametrave te cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor, përkatësisht Lejen Mjedisore të lëshuara nga MMPHI. |
| 5.8. | Leje ujorë për shfrytëzim të ujit | Operatori është ne procedurë për tu pajisur me Leje Ujore për shfrytëzim ARPL 3134/24, date 31.12.2021 |
| 5.9. | Leje ujorë shkarkimin e ujërave | Operatori është ne procedurë për tu pajisur me Leje Ujore për shkarkim ARPL Nr. 3133/21, date 31.12.2021 |
| 5.10. | Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave | Ne rast shkarkimi të ujërave, ujërat që dalin nga seperacioni me gurëthyes nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë vajra dhe yndyrna mbi vlerat e përcaktuara me Udhëzimi administrativ.Nr.02/2022 përkushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujrave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujorë. |

| **6. ZHURMA** | | |
|---|---|---|
| 6.1. | Burimet | Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat për mbrojtje nga zhurma. Analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara për vendet ku |

| | | |
|---|---|---|
| | | jetojnë dhe punojnë njerëzit. Në bazë të vlerave të lejuara dhe duke pasur parasysh distancen e ndërtesave të banimit si dhe kapacitetin e pajimeve dhe numrin e mjeteve transportuese që nevojitën për realizimin e procesit teknologjik për eksploatimin, thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, mund të konkludojm se nuk ka ndikime të mëdha negative në njerëzit që banojnë dhe veprojnë në rrethin të gurëthyesit me seperacion. Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon atë të lejuarën atëherë duhet të merren te gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e të lejuares sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punes të përdorin mjetet kundër zhurmës, mbajtëset në vesh. |
| 6.2. | Kontrolli dhe matjet | Kompania ne fjalë lidhur me thermimin dhe seperimimin e gurit gëlqeror ”FORTESA”sh.p.k, ka kryër matje të zhurmës i cili raport është brenda normave të lejuara. |
| 6.3. | Raportimet | Kompania ne fjalë lidhur me thermimin dhe seperimimin e gurit gëlqeror ”FORTESA”sh.p.k, do t’i kryëj matjet e zhurmës dhe të raportoj me kohë ne Ministri. |

| **7. TOKA** | | |
|---|---|---|
| 7.1. | Ndikimet në tokë | Ndikimet në Tokë Si ndikime negative në tokë gjatë realizimit të procesit teknologiik për thërmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror si aktivitet parësor mund të identifikohen:<br>• Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirembajtjes dhe riparimeve të makinave ngarkuese dhe transportuese.<br>• Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjate mirëmbajtjes dhe riparimeve të pajimeve dhe stabilimenteve prodhuese.<br>• Mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.<br>• Pluhuri i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura ne pasusin e sipërm (ndikimet në ajër). |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Ngjeshja e tokes të cilën e shkaktojnë makinat punuese.<br>• Mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese giatë furnizimit dhe ndërrimit të tyre. |
| 7.2. | Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë | Për të parandaluar e zvogluar sasinë e ndikimeve negative në tokë duhet marrë këto masa mbrojtëse:<br>• Me qëllim të ruajtjes së tokës nga pluhuri duhet në mënyrë të rregullt të mirëmbahen stabilimentet e thërrmimit dhe seperimit, dhe sistemi për depluhrim.<br>• Duhet të merren masat e nevojshme për moslëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajimet prodhuese<br>. • Vaji i makinave të ndërrohet në ofiqinën e caktuar dhe në kanalin i cili duhet të jetë i izoluar për mos depërtimin e tyre ne tokë dhe të ketë sistem të instaluar të gypave gjer në seperator të vajrave.<br>• Platoja dhe siperfaqet operacionale ku janë të vendosura pajimet prodhuese të betonohet dhe izolohet.<br>• Platoja dhe sipërfaqet operacionale ku bëhet mirëmbajta (servisimi) i makinave transportuese dhe pajimeve prodhuese të betonohet dhe izolohet.<br>• Makinat ngarkuese dhe transportuese pas kryerjes se orarit të punës të parkohen në vendin e caktuar enkas për to.<br>• Të ndërpritet puna në kohra me të reshura atmosferike me qëllim të mos ngjeshjes në masë të madhe të tokës.<br>• Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në lokacionin e gurthyesit me seperacion duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të |

| | | |
|---|---|---|
| | | deponohen në vende të posaqme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara, për mbeturinat tjera të ngurta të sigurohen kontinierë të posaqëm të cilët do të i zbrazin kompanite që kanë veprimtarin e grumbullimit të tyre.<br>• Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaqëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmanjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin e qytetit..<br>• Mbeturinat e lëngta që krijohen nga ndërrimi i vajrave të automjeteve transportuese dhe pajimeve prodhuese duhet të deponohen në enë të posaqme të cilat mbeturina do të i shiten kompanive të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura. |
| 7.3. | Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit | Pas përfundimit të jetë gjatësisë të seperacionit me gurëthyës , "FORTESA"sh.p.k, objektet ekzistuese të largohen nga lokacioni, bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi regjionale.<br>Të gjitha mbetjet e mbeturinave ngurta dhe ato të inerteve që ekzistojnë ne sipërfaqet e lokacionit si shtresa e dheut të kontaminuar pa tjetër duhet të largohen dhe të bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte, ashtu qe të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim.<br>Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit.<br>Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:<br>Qëllimi i rekultivimit i cili nënkupton sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), të kthehet në |

| | | |
|---|---|---|
| | | gjendje të përafërt me ambientin rrethues,dhe të mbjellën të lashtat periodike të cilat kultivohen ne rrethin të lokalitetit dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.<br>Për të qen rikultivimi sa më i suksesshëm duhet të kryhen këto faza të procesit të rikultivimit:<br>• Rikultivimi teknik.<br>• Rikultivimi agroteknik dhe<br>• Rikultivimi biologjik.<br>Me **rikultivimin teknik** do të krijohet një profil i ri i tokës, e cila mund të përdoret për nevoja tjera si psh. për mbjelljen e fidanëve të ndryshme (pemëve) frytë dhënëse, apo mbjelljen me të lashta periodike bujqësore.<br>Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e **rikultivimit agroteknik** e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetit agrokimike dhe pedologjike. Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re.<br>Për të llogaritur numërin e fidaneve për tërë ë sipërfaqen që do të rikultivohet, duhet të kalkulohet me distancën në mes rendeve dhe distancën në rend.<br>$N_f = S / a \times b$<br>S - paraqet sipërfaqen, a – paraqet distancën në mes rendeve b – paraqet distancën në mes fidaneve.<br>Qëllimi afatgjatë i **rikultivimit biologjik** është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siç janë: toka, flora, fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtarin bujqësore, dhe në silvikulturë. |

## 8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

<table>
<tr><td>8.1.</td><td>Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave</td><td>Kryesisht ato deponohen në vendpunishten e kompanisë dhe referohen si lëndë për shtrimin e pjesëve të poshtme të rrugëve.<br>Gjenerimi i mbeturinave shtepiake do të grumbullohen dhe do të vendosen në kontajner me kapak dhe mëpastaj nga kompania përgjegjëse regjionale e mbeturinave do të dërgohen në deponin respektive.<br>Poashtu kompania ka të zhvilluar planin për menagjimin e mbeturi-nave të bazuar në kërkesat ligjore të legjislacionit Kosovar.<br>Pjesë integrale e menagjimit të mbeturinave është edhe zbutja dhe monitorimi i tyre.<br>Mbetjet të cilat gjenerohen gjatë procesit të pastrimit të mikserave pas procesit të pastrimit, ngarkohen dhe përdoren si inerte për shtruarjen e bazamentit të rrugës.<br>Poashtu pjesë integrale e planit të menagjimit të mbeturinave është edhe menagjimi i karburantëve të lëngshme.</td></tr>
<tr><td>8.2.</td><td>Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave</td><td>Mbeturinat organike referohen nga kompania e higjienes në baza javore. Ndërsa, mbetjet nga inertet grumbullohen dhe largohen në baza javore gjatë verës (apo varësisht nga vëllimi i punëve), ndërsa gjatë dimirit sa herë të arrihet sasia prej $5m^3$.<br>Inertet kryesisht përdoren për shtruarjen e bazës së rrugëve të ndryshme të cialt kompania në vazhdimësi merret me liferimine e produkteve të tilla.</td></tr>
<tr><td>8.3.</td><td>Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave</td><td><table>
<tr><th>Mbeturina</th><th>Emri i mbeturinës</th><th>Shkalla e rrezikshmërisë</th><th>Lloji i deponimit</th></tr>
<tr><td></td><td>Letra</td><td>Jo të rrezikshme</td><td>Kontejner</td></tr>
<tr><td>17 02 03</td><td>Plastika</td><td>Jo të rrezikshme</td><td>Kontejner për mbetur</td></tr>
<tr><td>15 01 01<br>20 01 01<br>20 01 08</td><td>Mbeturinat e ngurta komunale</td><td>Jo te rrezikshme</td><td>Kontejner për mbetur</td></tr>
</table>
Mbeturinat te cilat do të gjenerohen gjatë aktivitetit te kompanisë te ashtuquajtura mbeturinat komunale deponohen në kontejner dhe pastaj</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | | barten me kamionë nga kompanitë e licencuar, të cilat i dërgojnë në deponit regjionale.<br>Ndërsa servisimin e makinerive transportuese e bene tek autoserviset e kontraktuara kështu qe nuk kemi gjenerim te vajrave. |
| 8.4. | Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër- kontratë me kompaninë me leje përkatëse | Gjatë aktivitetit te kompanisë nuk bëhet pranimi dhe klasifikimi i mbeturinave sipas llojeve ( në rast të përpunim dhe riciklimi). |
| 8.5. | Plani për menaxhimin e mbeturinave | Gjatë aktivitetit te kompanisë, nuk bëhet përpunim dhe riciklimi e mbeturinave.<br>Fabrika nuk i dërgon për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër, mbeturinat komunale deponohen në kontenjer dhe pastaj barten me kamionë nga kompanitë e licencuar, të cilat i dërgojnë në deponit regjionale. |
| 8.6. | Raportimi | Raportimi do të bëhet konform kërkesës nga organet kompetente. |

| **9. RREZIKU NGA AKSIDENTET** | | |
|---|---|---|
| 9.1. | Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm | Në aktivitetin thermim dhe seperim të gurit gelqrorë, nuk kemi deponim te karburanteve të lëngët nga edhe buron rrezikimi i mjedisit gjatë rasteve aksidentale. Aksidentet mund te ndodhin nga rrjedhjet aksidentale te lendeve djegëse dhe lubrifikuese nga automjetet transportuese nga pëlcitja e gypave hidraulikë. |
| 9.2. | Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre | Natyra e aktiviteteve dhe gama e produkteve të prodhuar nuk kërkojnë që të përdoren substanca të rrezikshme kimike dhe preparate tjera, andaj nuk është e nevojshme që të planifikohen masa shtesë me qëllim të zavendësimit të tyre. |
| 9.3. | Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave | Kryerja e aktiviteteve minuese dhe lloji i punimeve të cilat kryhen në gurore dhe bazën e betonjerës bartin në vete edhe rreziqet qe mund të paraqiten gjatë aksidenteve.<br>E gjithë kjo makineri e angazhuar normalisht që ofron një lloj rreziku për sigurin e të punësuarve në vendpunishte.<br>Andaj, kompania në fjalë planifikon që në të ardhmen e afër të angazhojë kompani profesionale me qëllim të trajnimit të stafit të |

| | | |
|---|---|---|
| | | angazhuar në punishte me qëllim të përmirësimit të aftësive të tyre në sigurin dhe ruajtjen e shëndetit në punë.<br>Masë tjetër preventivë është edhe mirëmbajtja e rregullt e makinerisë së angazhuar me qëllim të shmangies së aksidenteve dhe minimizimit të atyre që mund të jenë me fatalitet. |
| 9.4. | Raporti mbi gjendjen e sigurisë | Kompania ka hartuar Raportin mbi gjendjen e sigurisë. |
| 9.5. | Plani për mbrojtjen nga zjarri | Kompania ka hartuar Plan për mbrojtjen nga zjarri që është i pajisur edhe me aparat dore kundër zjarrit. |

| **10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT** | | |
|---|---|---|
| 10.1. | Ndërprerja momentale e punës së impiantit | Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut<br>Gjatë funksionimit kontinuel të kompleksit të seperacionit me gurëthyës "FORTESA" sh.p.k<br>Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut është minimal pasi kompania ka marre te gjitha masat për zvogëlimin e ndikimeve ne ajër, tokë, ujë etj. |
| 10.2. | Ndërprerja e punës | Nuk ka ndërprerje të punës nga Inspektorati i MMPHI-së |

| **11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT** |
|---|
| Gjatë funksionimit kontinuel të kompleksit të Kompanisë " FORTESA" sh.p.k<br>Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut është minimal pasi kompania ka marre te gjitha masat për zvogëlimin e ndikimeve ne ajër, tokë, ujë. Këto ndikime janë te paraqitura ne aplikacionin për dhënien e lejes mjedisore. |

| | |
|---|---|
| **Personi përgjegjës për mjedis**<br>**Emri mbiemri**<br>Valmir Kabashi | **Personi përgjegjës i kompanisë**<br>**Emri Mbiemri**<br>Valmir Kabashi |
| **Nënshkrimi**<br>________________ | **Nënshkrimi**<br>__________________ |

**DEKLARATA INVESTIVE E PROJEKTIT**

Unë **Valmir Kabashi,** me nr. personal: 1175708371, deklaroj që vlera investive e projektit është: **198, 000.00 € (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë euro).**

Nënshkrimi:

______________________ Vula: